

Legjionaret/ Berisha ne janar titullar tek Lazio

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 16 Nentor 2013 20:03



Largimi i Marketit drejt Milanit pritet ta beje titullar portierin shqiptar Etrit Berisha. Ky lajm konfirmohet nga mediat italiane qe e kane vleresuar maksimalisht ecurine e deritanishme te portierit qe u transferua nga Suedia. Berisha ka patur vetem nje mundesi per te luajtur me Lazion dhe ne ate rast ka bere mjaft mire. Tani qe Marketi pritet te largohet nga kryeqyteti drejt kuqezinjve te Milanit, Etriti mund te kete hapesira. Lazio ka bere nje investim mjaft te mire duke e afruar shqiptarin ne skuader dhe pas kesaj levizje tani i mbetet vetem te fitoje vendin e te padiskutueshmit ne porte.